



## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Beqir Kalludra, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Zyhdi Haziri, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Ahmeti, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.L. nga fshati ..., Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me paragrafi 3, nën-paragrafi 3.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr.554/2020, e datës 5 gusht 2020, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.284/2020, të datës 3 gusht 2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 18 janar 2021, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, ndërsa sipas detyrës zyrtare, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr.284/2020, i datës 3 gusht 2020, ashtu që konform nenit 364 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i pandehuri A.L., nga fshati ..., Komuna e Pejës,

## LIROHET NGA AKUZA

Sepse më datën 26 prill 2020, rreth orës 11:18, në parkun e mbrojtur “Bjeshkët e Nemuna”, pikërisht në fshatin Pepaj, Komuna e Pejës, me qëllim të vjedhjes kishte prerë trungun e llojit “breut” në sasi prej 1.20 metër kub, në atë mënyrë që i njëjti pa leje përkatëse për prerjen e druve dhe transportin e tyre, duke përdorur sharrën motorike, në vendin e lartcekur kishte prerë trungun e llojit “breut”, të cilin e kishte ngarkuar në automjetin e tij të markës “VWT4”, me targa ..., për çka i njëjti me të arritur në rrugën “Sakë Fazlija” në Pejë ndalohet nga zyrtarët policor, të cilët në bashkëpunim me zyrtarët e DFAPK, konstatojnë sasinë

drunore në vëllim prej 1.20 metër kub, e cila është gjetur në automjetin e të pandehurit, të cilat edhe i janë sekuestruar,

- me këtë kishte për të kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3, nën-paragrafi 3.1. të KPRK.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

Në pjesët tjera, aktgjykimi i ankimuar mbetet i pandryshuar, ndërsa ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë refuzohet si e pabazuar.

## A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë, me aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht me aktgjykimin e ankimuar, të pandehurin A.L. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3, nën-paragrafi 3.1. të KPRK dhe ndaj tij për shkak të kësaj vepre penale është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej 300 € (treqind Euro), të cilin dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 3 (tre) muajve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë, nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë, të cekur si më lart brenda afatit të caktuar, atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, ashtu që çdo 20 € (njëzet Euro) e dënimit me gjobë do t'i llogaritet me 1 (një) ditë burgim.

Është detyruar i pandehuri A.L. që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet Euro) dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë Euro), në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

E dëmtuara Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Zyra në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Të pandehurit i janë konfiskuar 1.20 metër kub trungje të llojit "bre".

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë Prokuroria Themelore në Pejë, për shkak të refuzimit të konfiskimit të automjetit, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket konfiskimit, ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet konfiskimi i përhershëm i automjetit-kombit me ngjyrë të gjelbër, me targa të regjistrimit ... dhe çelësat për ndezje të kësaj veture.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit, avokati Taulant Broqi, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesën e lartcekur ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta vërtetoj.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.1021/2020, të datës 27 tetor 2020, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet vetëm sa i përket konfiskimit, ashtu që ndaj të pandehurit të shqiptohet konfiskimi i përhershëm i veturës-kombit, me të cilin është kryer vepër penale.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë theksohet se me aktgjykimin e ankimuar janë shkelur dispozitat ligjore të KPP dhe atë neni 112, paragrafët 1 dhe 3, neni 283, paragrafi 1 dhe paragrafi 2.1. e 2.3., si dhe neni 370 paragrafi 9 të KPP. Në rastin konkret, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata e shkallës së parë është dashur që ta konfiskoj veturën e të pandehurit me të cilën është kryer vepra penale e lartcekur, veturë kjo e cila ishte sekuestruar në bazë të urdhrit UGJK.nr.58/2020, të datës 30 prill 2020. Arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë për refuzimin e konfiskimit të mjetit të lartcekur nuk është i mjaftueshëm, pasi që vetura në fjalë ka lehtësuar dhe mundësuar kryerjen e veprës penale. Në njëërën anë, gjykata e shkallës së parë ka konfiskuar drunjtë, ndërsa në anën tjetër nuk ka konfiskuar veturën me të cilën është kryer vepra penale, e që kjo bën që aktgjykimi i ankimuar të jetë kundërthënës. Andaj, duke u bazuar në këto rrethana, Prokuroria Themelore në Pejë i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lart.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPP, konstatoj se :

- aktgjykimi i ankimuar duhet të ndryshohet, ndërsa i akuzuari të lirohet nga akuza, siç është cekur më lart, kurse ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë është e pabazuar.

Me rastin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Pejë, por duke vepruar sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 394 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konstaton se me aktgjykimin e ankimuar është shkelur ligji penal sipas nenit 385 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1. të KPP, në dëm të të pandehurit A.L., pasi që vepra për të cilën është akuzuar nuk është vepër penale, për arsyet që do të paraqiten në vijim. Vepra penale vjedhja e pyllit është parashikuar në nenin 349 të KPRK, ndërsa formën themelore të kësaj vepre penale, sipas paragrafit 1 të këtij neni, e kryen “*Kushdo që me qëllim të vjedhjes pret trungjet në pyll dhe sasia e druve të prerë tejkalon 2 metra kub,...*”, për të cilën vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, për t’u konsideruar se është kryer forma themelore e kësaj vepre penale duhet që prerja e trungjeve në pyll të bëhet me qëllim të vjedhjes dhe sasia e druve të prera duhet që të tejkaloj 2 metra kub. Ndërsa, në paragrafin 2 të nenit të lartcekur është parashikuar formë e rëndë apo e kualifikuar e kësaj vepre penale, e cila ekziston “*Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni kryhet me qëllim të shitjes, ose*

sasia e druve të prerë tejkalon pesë (5) metra kub,...”, për të cilën vepër penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej tre (3) muaj deri në 4 (katër) vjet. Duke e bazuar në këtë dispozitë ligjore, për të ekzistuar kjo formë e rëndë e kësaj vepre penale, duhet që vepra penale sipas paragrafit 1 të nenit të lartcekur të kryhet me qëllim të shitjes ose sasia e druve të prerë të tejkalon pesë (5) metra kub. Në anën tjetër, në paragrafin 3 të nenit 349 të KPRK, janë parashikuar format edhe më të rënda të veprës penale vjedhja e pyllit, të cilat ekzistojnë “Nëse vepra penale nga ky nen kryhet : 3.1. në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm; 3.2. me qëllim që drunjë e prerë të shiten, pavarësisht sasisë së drurit të përfshirë,...”, për të cilat vepra penale është parashikuar dënimi me gjobë dhe me burgim prej 6 (gjashtë) muaj deri në 5 (pesë) vjet. Nga vetë përmbajtja e kësaj dispozite ligjore, rezulton se për të ekzistuar vepra penale sipas paragrafit 1 lidhur me paragrafin 3, nën-paragrafi 3.1. të KPRK, për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i akuzuari A.L., duhet që në mënyrë kumulative të përmbushen këto kushte :

- 1) që prerja e trungjeve në pyll të bëhet me qëllim të vjedhjes;
- 2) që sasia e druve të prera duhet që të tejkaloj 2 metra kub dhe
- 3) që vepra penale të kryhet në pyllin e mbrojtur, në parkun e mbrojtur apo në pyllin tjetër me destinim të posaçëm.

Nga aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë dhe nga aktgjykimi i ankimuar, si dhe nga shkresat tjera të lëndës, rezulton se në rastin konkret i pandehuri A.L., ditën kritike, kishte bërë prerjen e trungut të llojit “breut”, në sasi prej 1.20 metër kub, në parkun e mbrojtur “Bjeshkët e Nemuna”, pikërisht në fshatin Pepaj, Komuna e Pejës. Mirëpo, me asnjërin prej provave që gjenden në shkresat e lëndës nuk është vërtetuar se sasia e druve të prera ka qenë mbi 2 (dy) metra kub, e që është element themelor i figurës së veprës penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i pandehuri A.L.. Nga aktakuza dhe shkresat tjera të lëndës, në veçanti nga procesverbali mbi konfiskimin e sortimenteve pyjore, nr.000493, të datës 27 prill 2020, rezulton se në rastin konkret bëhet fjalë për 1.20 metër kub të drunjëve. Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lart, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka vendosur që të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, ndërsa i akuzuari A.L. të lirohet nga akuza, pasi që vepra për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor nuk përbën vepër penale, kështu që edhe në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë e ka shkelur ligjin penal në dëm të pandehurit, kur të njëjtin e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ishte akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, PP/II.nr.554/2020, të datës 12 maj 2020. Kjo edhe për faktin se as nga përshkrimi faktik i aktakuzës dhe i aktgjykimit, por as edhe nga provat që gjenden në shkresa të lëndës nuk rezulton që i pandehuri ta ketë prerë trungun e lartcekur me qëllim të shitjes.

Duke u bazuar në nenin 454 paragrafi 1 të KPP, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka vendosur që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

Meqenëse i pandehuri A.L. është liruar nga akuza, për shkak se vepra për të cilën ishte akuzuar nuk përbën vepër penale, ndërsa në anën tjetër, sendet për të cilat është propozuar

konfiskimi nuk janë sende që parashihen në nenin 282 paragrafi 2 të KPP, atëherë edhe ankesa e Prokurorisë Themelore në Pejë, është refuzuar si e pabazuar.

Duke u bazuar në këto që u thanë më lart e në bazë të nenit 398 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS  
Departamenti i Përgjithshëm  
PA1.nr.1008/2020, datën 18 janar 2021

Bashkëpunëtori profesional,  
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit:  
Afrim Shala

Kryetar i kolegjit,  
Beqir Kalludra

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Zyhdi Haziri

\_\_\_\_\_